

## INFORMACION

### për personat me të drejtë kujdestarie

Në shkollat e mesme, klasat e ulta të gjimnazit dhe shkollat speciale (Sonderschule) shumë nxënës dhe nxënese të klasës së pestë dhe të gjashtë do të pajisen në vjeshtë me një laptop ose tablet<sup>1</sup>.

Kjo ka si qëllim që t'ua bëjë të mundur të gjithë nxënësve dhe nxëneseve pjesëmarrjen në shkollimin digjital në kushte të barabarta. OeAD, si agjenci e Federatës, e mbështet nismën "Mësimi digjital" të Qeverisë Federale Austriake dhe është personi juaj kontaktues për çështje të ndryshme që lidhen me këtë iniciativë.

Me OeAD mund të komunikoni nëpërmjet [digitaleslernen@oead.at](mailto:digitaleslernen@oead.at) dhe prej datës 28.6.2021 edhe përmes telefonit!



Këtë informacion për prindërit e gjeni edhe në gjuhë të tjera në faqen e internetit: [digitaleslernen.oead.at](http://digitaleslernen.oead.at)

## PËRSE DUHEN PAJISJET ELEKTRONIKE DIGJITALE?

Kompetencat digjitale po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme në jetën e përditshme dhe gjatë ushtrimit të profesionit. Përveç kësaj, laptopët, tabletet dhe mjetet digjitale mundësojnë që të mësuarit të organizohet në mënyrë të larmishme nëpërmjet metodave mësimore inovative dhe që nxënësit dhe nxënëset të mbështeten më mirë në mënyrën e tyre individuale të të mësuarit.

## PAJISJET ELEKTRONIKE DIGJITALE

Shkolla juaj ka vendosur në Komisionin e Përbashkët të Shkollave (Schulgemeinschaftsausschus) që të bëhet një shkollë digjitale dhe ka zgjedhur në përputhje me konceptin e saj pedagogjik llojin e përshtatshëm të pajisjes elektronike. Për të bërë të mundur një përdorim pa probleme dhe një administrim të mirë të pajisjeve në shkollë, për çdo shkollë do të përdoret vetëm një tip pajisjeje elektronike.

**Kompetencë digjitale do të thotë p. sh.:**

- + Përdorim i shkathët dhe i sigurt i pajisjeve elektronike digjitale
- + Përdorim plotësisht i përgjegjshëm i internetit dhe mjeteve digjitale

### Pajisje elektronike digjitale janë

- + Laptopët (notebooks)
- + Tabletet (tablets) ose
- + Kompjuterët e tipit hibrid (convertibles) – si në rastin e chromebooks

**Ju doni të dini cilën pajisje elektronike do të marrë fëmija juaj? Shkolla juaj ju informon me kënaqësi për këtë dhe ju shpjegon se si do të integrohen pajisjet në jetën e përditshme në shkollë!**

Fëmija juaj mund ta përdorë pajisjen elektronike edhe në shtëpi. Ajo duhet të jetë në gjendje të funksionojë të paktën katër vjet për mësimin në shkollë. Kjo do të thotë që djali apo vajza juaj duhet ta përdorë me përgjegjësi këtë pajisje. Në shkollë do të përcaktohen rregulla të qarta për përdorimin e pajisjeve.

**Ju lutemi ta ndihmoni fëmijën tuaj edhe në shtëpi, që të mësojë se si të sillet me përgjegjësi në këtë drejtim!**

P. sh. në webinarët që OeAD mban së bashku me [saferinternet.at](http://saferinternet.at) dhe BMBWF mund të mësoni se si mund ta ndihmoni më mirë fëmijën tuaj! Më shumë rreth kësaj mësoni te [digitaleslernen.oead.at](http://digitaleslernen.oead.at).

## pagesa individuale

Duhet të paguani 25% të vlerës për përdorimin privat të pajisjes. Kjo është shuma që duhet të paguhet nga personi që ka të drejtën e kujdestarisë (Erziehungsberechtigte). Do të jetë afërsisht 100 euro dhe ndryshon pak sipas llojit të pajisjes. Shkolla juaj do t'ju informojë për shumën që duhet të paguani (Selbstbehalt)!

<sup>1</sup> Ligji Federal për financimin e digjitalizimit të mësimit shkollor (SchDigiG) është baza ligjore që siguron kornizën e zbatimit.



## DORËZIMI I PAJISJEVE ELEKTRONIKE DHE GARANCIA

Përpara dorëzimit të pajisjes do t'ju informojmë për kornizën ligjore, midis të tjerash për detyrimin e pagesës prej 25% të vlerës (gati 100 euro) dhe për mënyrën e dorëzimit të pajisjeve.



**Pas dorëzimit të pajisjes pronësia mbi pajisjen, si dhe rreziku e përgjegjësia për garancinë kalojnë te ju, respektivisht te fëmija juaj!**

Garancia e pajisjeve zgjat 4 vjet. Ne ju rekomandojmë gjithashtu që të bëni një sigurim vullnetar, me qëllim që të jeni të siguruar për gjithçka që mund të ndodhë (p. sh. humbja e pajisjes). Informacione të detajuara për garancinë dhe sigurimin do të pasojnë në të ardhmen.

## MUNDËSI LIRIMI

Në kushte të caktuara mund të paraqisni një kërkesë për t'u liruar nga pagesa. Kushtet e lirimit janë: marrja e një ndihme (Beihilfe) për një vëlla ose motër në vitin e kaluar shkollor, marrja e sigurimit minimal (Mindestsicherung), ndihma sociale (Sozialhilfe), një shtesë barazuese (Ausgleichzulage) ose ndihma emergjente (Notstandshilfe), si dhe lirimi nga detyrimi për të paguar tarifë televizive.<sup>2</sup> OeAD do t'ju vërë në dispozicion një listë të dokumenteve zyrtare që duhet të dorëzoni për t'u

liruar nga pagesa. Përveç kësaj, ju do të merrni edhe informacione se si ta dorëzoni një kërkesë të tillë. Në rastin kur fëmija juaj p. sh. gjatë vitit shkollor e ndryshon shkollën dhe kalon në një shkollë që përdor një tjetër tip pajisjeje, do të ketë një sasi pajisjesh me mundësi shkëmbimi për të marrë pajisjen e nevojshme.



## KENI PYETJE OSE DËSHIRA NË LIDHJE ME NISMËN PËR PAJISJET ELEKTRONIKE?

### Atëhere drejtohuni te OeAD!

Në faqen e internetit të nismës për pajisje elektronike "Mësimi digjital" („Digitales Lernen“) ([digitaleslernen.oead.at](http://digitaleslernen.oead.at)) ju sqarojmë për një radhë temash. Këtu gjeni të gjitha informacionet rreth kësaj nisme, datat e aktiviteteve, një nënfaqe më vete për personat me të drejtë kujdestarie (së shpejti me video sqaruese për temat më të rëndësishme!), si dhe një zonë FAQ me përgjigje për pyetjet më të shpeshta.

Nëse keni ende pyetje për nismën e pajisjeve elektronike, mund t'i drejtoheni ekipit të OeAD nëpërmjet e-mailit [digitaleslernen@oead.at](mailto:digitaleslernen@oead.at) dhe pas datës 28.6.2021 edhe përmes telefonit! Të dhëna për kontaktet mund të gjeni te [digitaleslernen.oead.at](http://digitaleslernen.oead.at).

**Ndihmoheni fëmijën tuaj për të mësuar si ta përdorë me përgjegjësi laptopin (Notebook) ose tabletin (Tablet)!**

Qëndroni të informuar!  
Regjistrohuni për të marrë Newsletter:



## OFERTA PËR VEBINARE

Prej shtatorit do të organizohen vebinare për ju si persona me të drejtë kujdestarie (Erziehungsberechtigte): duke nisur prej informacioneve për përdorimin e pajisjeve në mësim deri te përdorimi i pajisjeve digjitale në shtëpi – në këto vebinare do t'ju përgjigjemi pyetjeve tuaja!

**Pjesëmarrja është falas, informacione më të hollësishme për secilin webinar do të gjeni në vijim në faqen e internetit të OeAD.**

